

"Kartele Shoqëruese e Praktikës"

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST sh.a)

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues GRE, Nr. Prot. 1133/2, Data 02.12.2020

Shkurtimi i lëndës Mbi përbërësit e detyrimeve ligjore për

3F

Për trajtim nga: Transparenca në Tregun e Energjisë Elektrike

(struktura të tjera të ngarkuara)

Me porosi: DK: A. Polo

Afati: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (brenda ditës) Pa afat/për dijeni Tjetër ___ ditë

Nr. 53171 Prot. Datë 04.12.2020 Nënshkrimi: _____

Marrë në dorëzim: 07.12.2020 Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): I. Neziri, L. Ananitasij, G. Merkoj, A. Roca

Me porosinë: Të përgatitet përgjigje ERE-s për të gjitha pikat e cituara, të menç merr për

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim Specialistit: 2 Uka, 2 Mesa

Me porosinë: Të nxirren të dhënat për përkasin

Trajtimi i materialit përfunduar më: dispozicioni Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: për publikim Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria e Monitorimit të Tregut

Nr. 1133 / Prot
2

Tiranë, më 2 .12.2020

Lënda: Lidhur me shkesen nr.5817/1 prot. date 22.10.2020, mbi permbushjen e detyrimeve ligjore mbi Transparencën në Tregun e Energjisë Elektrike

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST sh.a ✓

Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9, Kashar

Tiranë

Z. Drenova,

NR.5817/PROT. DT. 04-12.2020
2

Me tuajen nr.5817/1 prot. date 22.10.2020, ne vijim te komunikimeve te mepareshme mbi permbushjen e detyrimeve ligjore mbi Transparencën në Tregun e Energjisë Elektrike, si dhe ne pergjigje tones me nr.1133 prot., date 29.09.2020, nder te tjera jeni shprehur... "Të gjitha të dhënat e përmendura ne shkresën tuaj do te bëhen publike në faqen zyrtare <http://www.ost.al> brenda muajit Tetor 2020".....

Nga monitorimi i faqes se internetit zyrtare te OST sh.a. rezulton se akoma nuk jane permbushur detyrimet ligjore në kuadër të transparencës per të publikuar të përditësuarat të dhënat dhe Informacionet sipas formatit te kerkuar, dhe afateve kohore te percaktuara ne aktet perkatese.

Ne menyre te detajuar dhe te perseritur paraqesim si vijon, te dhenat dhe informacionin qe konstatohen akoma te pa publikuara ne faqen tuaj te internetit :

➤ Sipas **Ligjit nr. 43/2015** "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar:

- Pasqyrat financiare vjetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardet e kontabilitetit, parashikauer ne Nenin 35, pika 3.
- Procedurat për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit, neni 56, pika 1, gërma "ë";

➤ Sipas "**Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike**", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.08.2016, të ndyshuara:

- Publikimin mujor të një liste që identifikon çdo sistem matës për të cilin kërkohet kontroll automatik dhe/ose komunikim, por që nuk është instaluar dhe nuk operon - kapitulli XIV pika 9.3;
- Parashikimin e kërkesës ose të ngarkesës, - kapitulli XVI pika 5, gërma "v";
- Parashikimin e gjenerimit ose injektimit, - kapitulli XVI pika 6, gërma "iii";
- OST-ja do të bëjë informacionin e mëposhtëm dhe do ta publikojë në faqen e vet të internetit, sipas kapitullit XVI, pika 8:

i) parashikojë kërkesat për rezervë të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;

- ii) parashikimin për shërbimet ndihmëse të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;
- iii) gjenerimin e disponueshëm – kapacitetin e pritshëm total të disponueshëm të gjenerimit;
- iv) kërkesën maksimale të pritshme dhe kërkesën mesatare orare në MW për çdo muaj në vitin kalendarik;
- v) vlerësimet e humbjeve në sistemin e transmetimit në GWh në bazë javore;
- vi) vlerësimet e kufizimeve të paparashikuara në sistem në GWh në bazë javore;

Te dhenat për ngarkesën të publikuara nga OST sh.a. në faqen e internetit të përmendura më sipër nuk janë të paraqitura sipas afateve kohore dhe formatit të përkohshëm në aktet ligjore të përmendura në këto shkresë.

➤ Sipas **“Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të Tregut të Energjisë Elektrike”**, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017:

- Informacioni mbi ngarkesën e përgjithshme - pika 3.1.1.
- Parashikimi i ngarkesës totale të javës në avancë - pika 3.3.2.
- Parashikimi i ngarkesës totale të muajit në avancë - pika 3.4.2.
- Parashikimi i ngarkesës totale të vitit në avancë - pika 3.5.2.
- Informacioni në lidhje me mos disponueshmërinë e njësive të konsumit - pika 3.6.1, dhe pika 3.6.5;
- Ndryshimet në disponueshmërinë faktike të njësive të konsumit - sipas pikës 3.7.4;
- Infrastruktura e transmetimit - Informacioni duhet të publikohet sipas përcaktimeve të pikës 4.1.2;
- Menaxhimi i kongestionit ridispeçerimi - pika 4.13.2.
- Raport i menaxhimit të kongestionit - pika 4.15.2.
- Fuqia e përgjithshme gjeneruese e instaluar - pika 5.1.4.
- Kapaciteti i instaluar sipas njësive prodhuese - pika 5.2.2.
- Kapaciteti i instaluar sipas njësive prodhuese - pika 5.2.5.
- Mosdisponueshmëria e planifikuar e njësive prodhuese - pika 5.7.4;
- Mosdisponueshmëria faktike e njësive prodhuese - pika 5.8.5;
- Gjenerimi faktik për njësi - pika 5.9.3;
- Rezerva energjetike - pika 5.12.4;
- Sasia e rezervave balancuese të kontraktuar - Të dhënat të cilat do të publikohen:
 - (a) burimi i rezervës (gjenerim ose ngarkesë);
 - (b) llojin e rezervave (p.sh. rezerva për kontrollin e frekuencës, rezerva për rivendosjen e frekuencës, rezerva për zëvendësim),
 - (c) periudhën kohore për të cilën janë kontraktuar rezervat (p.sh. orën, ditën, javën, muajin, vitin, etj.) - pika 6.2.2;
- Vëllimet e rezervave të aktivizuara të balancimit - Duhet të publikohet informacioni i mëposhtëm:
 - (a) energjia balancuese e aktivizuar (MWh) në intervalin llogaritës;
 - (b) lloji i energjisë balancuese të aktivizuar (sekondare dhe terciare);
 - (c) burimi i rezervës së energjisë balancuese të aktivizuar (gjenerim ose ngarkesë);
 - (d) drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë) - pika 6.5.2;
- Vëllimet e rezervave të aktivizuara të balancimit sipas - pikës 6.5.3;
- Vëllimi total i disbalancave sipas pikës 6.8.2;
- Balanca mujore financiare - bazuar në përcaktimet e pikës 6.9.2;

- Balanca mujore financiare - Në rast të korigjimit të bilancit financiar, Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e korigjuara nga pika 6.9.1 - pika 6.9.3;
- Sipas **“Kodit të Transmetimit”**, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 129, datë 04.06.2018:
 - Publikimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit brenda 30 ditëve nga miratimi në ERE sipas - nenit 22, pika 5;
 - Procedurat e Aplikimit për Lidhje (të re dhe/ose modifikim), në zbatim të “Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit” miratuar me vendim të Bordit të ERE nr 87, datë 20.04.2018.
 - Të dhënat dhe shkëmbimi i informacionit mepërdoruesit e rinj ose egzistues të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit – sipas nenit 31, pika 1;
- Sipas **“Rregullores së procedurave për Lidhjet e Reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”**, miratuar me vendim të Bordit të ERE me nr 87, datë 20.04.2018:
 - Tarifat e lidhjes - OST do të publikojë në faqen e saj në web vlerën aktuale të Tarifës së Aplikimit dhe Tarifës për Mbikqyrjen - pika 4.6.

Duke qene se OST sh.a., eshte anëtare me te drejta te plota e ENTSO-E, duhet qe te gjithë të dhënat dhe informacionet ti publikoje edhe në gjuhën Angleze. Dergimi për publikim i të dhënave bazë të tregut te realizohet sipas afateve dhe përmbajtjes të përcaktuar ne “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të Tregut të Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017.

Ri sjellim në vëmendjen tuaj se niveli i transparencës së operatorëve të sistemit të transmetimit për vendet anëtare monitorohet dhe raportohet gjithashtu edhe nga Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë, ku për sistemit tone të transmetimit konstaton se niveli i publikimet te këtyre të dhënave dhe informacioneve është relativisht i ulët karasuar legjislacionin në fuqi për këtë qëllim dhe nivelin e zbatuesmërisë nga vendet e rajonit.

Për gjithë sa më sipër, kerkojme marrjen e masave per publikimin e këtyre të dhënave sipas legjislacionit në fuqi, brenda dates 15 Dhjetor 2020, mbani në konsideratë së mospërmbushja e detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi ju bën subjekt shqyrtimi për kundërvajtjet administrative, konform nenit 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Duke qene te hapur per cdo sqarim te metejshem, mbetemi,

Me respekt,

KRYETARI
Petrit AHMETI

